



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.90

21 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9764 datë 9.7.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 2609
Ligj nr.9765 datë 9.7.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar 2611
Ligj nr.9766 datë 9.7.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar 2614
Ligj nr.9767 datë 9.7.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. 2616
Ligj nr.9768 datë 9.7.2007	Për një ndryshim në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 2617
Ligj nr.9769 datë 9.7.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 2617
Ligj nr.9770 datë 9.7.2007	Për një ndryshim në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar 2621

LIGJ
Nr.9764, datë 9.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 e 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 22 “Taksa mbi ndërtesat”, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo në pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.”.

Neni 2

Aneksi nr.1 “Nivelet treguese të taksës mbi ndërtesat” zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5393, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKSI 1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë minimale të ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastrë Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m2 në vit			
I. Ndërtesa banimi			
- ndërtuar para 1993-shit	15	10	5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993-shit	30	12	6
II. Ndërtesa të tjera			
- për tregti dhe shërbime	200	150	100
- të tjera	50	30	20
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	200	200	200

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për ndërtesat në zonat urbane (Bashkitë), si dhe për ndërtesat në të gjithë zonat (urbane dhe rurale) të seksionit III të tabelës “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike”.

Shënim II: Në zonat rurale (komunat), niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës (përjashtuar seksionin III) është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

LIGJ
Nr.9765, datë 9.7.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 19 pika 2, pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“ç) për lëndët djegëse të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, për nevojat e veta apo për shitje, sipas sasisë, kushteve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) për lëndën djegëse të konsumuar në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je dhe sipas kushteve e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 19 pika 4 shfuqizohet.

Neni 3

Shtojca 1 që i bashkëlidhet ligjit zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër e titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5394, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCA 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	PËRSHKRIMI	SHKALLA TATIMORE
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	50 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	100 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëlsuese	2 lekë/litri
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj me sasi ≤ 200 000 hektolitër/vit Nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 200 000 hektolitër/vit	30 lekë/litri 40 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara, shampanjë, musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 1 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 1 000 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 300 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 300 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë /litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatruar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind. - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 20 000 hektolitër/vit. - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 20 000 hektolitër/vit	150 lekë /litri 200 lekë /litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	70 lekë /litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë /litri
IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	40 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg

V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë /litri
27 10 11 51 27 10 11 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë /litri
27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21	Vajgurët Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 0
27 10 19 31 deri 27 10 19 49	Vajra të rënda (gazoil)	75 për qind por jo më shumë 37 lekë për litër dhe jo më pak se 17 lekë për litër.
27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	13 lekë /kg
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/ kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte dhe vajra të tjera	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyror; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg
34 03 19 91 34 03 99 10	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
VI	ARTIKUJ KOZMETIKË, PARFUMERI DHE TUALETI	
33 03 00 10	Parfume	60 për qind
33 03 00 90	Ujëra tualeti	60 për qind
33 07 20 00	Deodorante	60 për qind

LIGJ
Nr.9766, datë 9.7.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Tabela nr.1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat”, referuar në nenin 9 e që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me pasqyrën nr.1, me të njëjtin titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Në nenin 21 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1 shkronjat “h” e “j” ndryshohen si më poshtë:

“h) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje, të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;”

“j) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte të tjera nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, për qëllime tatimore, nuk njihen si shpenzime të zbritshme shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shumat e sponsorizuara për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit”.

2. Pas shkronjës “m” shtohen shkronjat “n”, “nj” e “o” me këtë përmbajtje:

“n) shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull;

nj) shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

o) shpenzimet për shërbime të ndërtimit, montimit dhe punime të tjera të faturuara shoqërive të ndërtimit, nga tatimpagues të biznesit të vogël.”.

3. Në pikën 2 fjalja e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Ky kufizim nuk zbatohet për bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.”.

Neni 3

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin deri më 31 dhjetor 2007 është 20 për qind, ndërsa nga data 1 janar 2008 do të jetë 10 për qind.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5395, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PASQYRA NR.1
TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në muaj)	Përqindje	
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10 000	0 për qind
10 001 +	30 000	+ 10 për qind të shumës mbi 10 000 lekë
30 001 +	Më tepër	10 për qind të shumës mbi 0 lekë

LIGJ
Nr.9767, datë 9.7.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17/1, në fund të pikës 4 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:
“Oficerët e Policisë Tatimore gëzojnë të njëjtat attribute me oficerët e Policisë Gjyqësore.
Procedura e dhënies së këtyre attributeve rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 2

Në nenin 36 shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:
“ç) kur tatimpaguesi kryen, me lekë në dorë, transaksione shitblerjeje, që kalojnë kufirin e përcaktuar në nenin 36/1 të këtij ligji.”.

Neni 3

Neni 36/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36/1

Arkëtimet dhe pagesat

Tatimpaguesit mund të kryejnë pagesa në cash për blerje mallrash e shërbimesh deri në shumën 300 000 lekë për çdo blerje, por jo më shumë se 10 për qind të totalit të blerjeve gjatë periudhës tatimore. Mbi këtë shumë, pagesat duhet të kalojnë nëpërmjet xhirimeve në llogarinë bankare.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5396, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9768, datë 9.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 62 pika 3 paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Personi, që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e kështit mujor të përfitimit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5397, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9769, datë 9.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8977, DATË 12.12.2002
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“ 1) Taksa portuale, që përbëhet nga:

- a) taksa e anijes;
- b) taksa e fenerit;
- c) taksa për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, të kapitenerisë së porteve dhe autoritetet e tjera.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë dhe paragrafi i dytë ndryshohen si më poshtë:

“Taksat portuale paguhet për një periudhë njëmuore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji e që është pjesë përbërëse e tij, për të gjitha anijet, që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare, pavarësisht nga numri i prekjeve.

Veprim tregtar i anijes quhet ngarkimi dhe/ose shkarkimi i mallrave, zbarkimi dhe/ose imbarkimi i udhëtarëve, përpunimi i anijeve turistike dhe i jahteve/cruiser-ëve.

Anijet me flamur shqiptar dhe anijet që mbajnë flamurin e shtetit, me të cilin vendi ynë ka marrëveshje reciprociteti, gëzojnë të drejtën t'i paguajnë taksat portuale për një periudhë njëvjeçare.”.

b) Shkronja “e” shfuqizohet.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Taksa e importit të mjeteve të përdorura caktohet:

5.1. Për mjetet me 10 ose më shumë vite përdorimi:

- a) autoveturat 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;
- b) mjetet e tjera për transportin e jo më shumë se 10 personave, mikrobusë, furgona dhe mjetet e tjera për transportimin e mallrave, me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 128 000 (njëqind e njëzet e tetë mijë) lekë;

c) autobusët dhe mjetet e tjera për transportin e mallrave, me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 160 000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

ç) traktorët rrugorë (koka tërheqëse): 64 000 (gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë.

5.2. Për mjetet me më pak se 10 vite përdorimi:

- a) autoveturat 40 000 (dyzet mijë) lekë;
- b) mjetet e tjera për transportin e jo më shumë se 10 personave, mikrobusë, furgona dhe

mjete të tjera për transportimin e mallrave, me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë;

c) autobusët dhe mjetet e tjera për transportin e mallrave, me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë;

ç) traktorët rrugorë (koka tërheqëse): 48 000 (dyzet e tetë mijë) lekë.

5.3. Taksa e importimit të autovehikulave llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

Taksa fikse x cilindrata e motorit x koeficienti i viteve të përdorimit;

- "Taksa fikse" për çdo autovehikul me benzinë është 20 000 (njëzet mijë) lekë, ndërsa për çdo autovehikul me naftë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

- "Cilindrata e motorit" është vëllimi i dhomës së djegies së motorit, i shprehur në centimetër kub (cm³).

- "Koeficientët e viteve të përdorimit" janë si më poshtë:

i) deri në 2 vite nga data e prodhimit: 0,0016;

ii) mbi 2 deri në 4 vite nga data e prodhimit: 0,0024;

iii) mbi 4 deri në 7 vite nga data e prodhimit: 0,0029;

iv) mbi 7 deri në 10 vite nga data e prodhimit: 0,0032;

v) mbi 10 vite nga data e prodhimit: 0,0048.

Me "vite përdorimi" kuptojmë diferencën ndërmjet vitit, kur mjeti hyn për qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me vitin e prodhimit."

Neni 3

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën "a" nën pikat "i" dhe "ii" ndryshohen si më poshtë:

"i) anijet e shërbimeve portuale në porte;

ii) anijet luftarake."

b) Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) anijet, që nuk kryejnë veprime tregtare, përjashtohen vetëm nga pagesa e taksës së anijes."

2. Në pikën 4, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) automjetet e huaja përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit për 60 ditë qëndrimi në vit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe paguajnë vetëm 1 euro në çastin e daljes. Për çdo ditë qëndrimi mbi këtë periudhë, taksa e qarkullimit llogaritet sipas lidhjes 4, që i bashkëlidhet këtij ligji."

Neni 4

Lidhja nr.1 "Niveli i taksave portuale në Republikën e Shqipërisë", që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 5

Pikat 7, 8 e 9 të lidhjes nr.2 "Taksat për shërbimet konsullore" ndryshohen si më poshtë:

"7. Për shtetasit e huaj, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike, nëpërmjet shoqërive turistike, taksa e vizës është sipas parimit të reciprocitetit, por jo më shumë se 1 euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikave tokësore dhe ujore të kalimit kufitar dhe jo më shumë se 10 euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar ajror.

8. Për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, taksa e hyrjes është sipas parimit të reciprocitetit, por jo më shumë se 1 euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikave tokësore dhe ujore të kalimit kufitar dhe jo më shumë se 10 euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar ajror.

9. Për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike, taksa e hyrjes është sipas parimit të reciprocitetit, por jo më shumë se 1 euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikave tokësore dhe ujore të kalimit kufitar dhe jo më shumë se 10

euro, për ata që hyjnë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar ajror.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5398, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIDHJA 1 NIVELI I TAKSAVE PORTUALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Lloji i taksave Portuale	Për çdo ton neto të regjistrit të anijeve për një muaj	Për çdo ton neto të regjistrit të anijeve për një vit
Taksë e anijes:	EURO	EURO
Për anije që kanë tonazh deri në 50 NRT	10	30
Për anije që kanë tonazh nga 51 NRT deri në 500 NRT	0,5	1
Për anijet mbi 501 NRT	1,0	2
Për anijet traget, pasagjerë dhe Ro-Ro	1,50	5
Për anijet turistike, sportive, jahte	0,10	
Krujzera	0,4	
Taksë feneri:	0,1	
për të gjitha anijet		
Taksë për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, kapitenerisë së porteve dhe autoritetet e tjera:		
Për të gjitha anijet pa përjashtim	0,40	

Taksat portuale paguhen para nisjes së anijes nga porti.

Anijet e huaja i paguajnë taksat portuale në valutë lirisht të konvertueshme, kurse anijet e personave juridikë ose fizikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë paguajnë në valutë ose në lekë.

LIGJ
Nr.9770, datë 9.7.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8981, DATË 12.12.2002 “PËR MIRATIMIN E
NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në kapitullin 87 të aneksit, që i bashkëlidhet ligjit nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, referuar në nenin 1/4 të ligjit, shtohen artikujt e nomenklaturës së kombinuar të mallrave, me kodet tarifore, të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5399, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Kodet e makinave

Kodi	Pershkrimi	Tarifa Eshte	Behet
8702 10 11	Te reja	15	0
8702 10 19	Te perdorura	15	0
8702 10 91	Te reja	15	0
8702 10 99	Te perdorura	15	0
8702 90 11	Te reja	15	0
8702 90 19	Te perdorura	15	0
8702 90 31	Te reja	15	0
8702 90 39	Te perdorura	15	0
8702 90 90	Me motore te tjere	15	0
8703 10 11	Mjetet e transportit vecanerisht te projektuara per udhetime ne bore	15	0
8703 10 18	Te tjera	15	0
8703 21 10	Te reja	2	0
8703 21 90	Te perdorura	15	0
8703 22 10	Te reja	2	0
8703 22 90	Te perdorura	15	0
8703 23 11	Furgonet	2	0
8703 23 19	Te tjera	2	0
8703 23 90	Te perdorur	15	0
8703 24 10	Te reja	2	0
8703 24 90	Te perdorura	10	0
8703 31 10	Te reja	2	0
8703 31 90	Te perdorura	15	0
8703 32 11	Furgonet	2	0
8703 32 19	Te tjera	2	0
8703 32 90	Te perdorura	15	0
8703 33 11	Furgonet	2	0
8703 33 19	Te tjera	2	0
8703 33 90	Te perdorura	15	0
8703 90 10	Me motore elektrike	15	0
8703 90 90	Te tjera	15	0
8704 21 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8704 21 31	Te reja	2	0
8704 21 39	Te perdorura	2	0

8704 21 91	Te reja	2	0
8704 21 99	Te perdorura	2	0
8704 22 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8704 22 91	Te reja	2	0
8704 22 99	Te perdorura	2	0
8704 23 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8704 23 91	Te reja	2	0
8704 23 99	Te perdorura	2	0
8704 31 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8704 31 31	Te reja	2	0
8704 31 39	Te perdorura	2	0
8704 31 91	Te reja	2	0
8704 31 99	Te perdorura	2	0
8704 32 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8704 32 91	Te reja	2	0
8704 32 99	Te perdorura	2	0
8704 90 00	Te tjera	2	0
8709 11 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0
8709 11 90	Te tjera	2	0
8709 19 10	Projektuar posacerisht per transportin e materialeve shume radioaktive (Euratom)	2	0

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

i.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii.	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi.	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 19.7.2007
Doli nga shtypi më 21.7.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë